

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar
Financial Accounting

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 13.01.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Të dhënat në vijim i takojnë kompanisë EDRA shpk për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016:

EDRA

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2016

	€'000
Fitimi operativ	15,730
Shpenzimet e interesit	(730)
Fitimi para tatimit	<u>15,000</u>
Tatimi	(4,350)
Fitimi neto	<u>10,650</u>

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2016

	2016		2015	
	€'000	€'000	€'000	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		44,282		26,574
<i>Pasuritë qarkulluese</i>				
Stoqet	3,560		9,635	
Llogaritë e arkëtueshme	6,405		4,542	
Paraja e gatshme	<u>559</u>		<u>1,063</u>	
		10,524		15,240
<i>Totali i pasurive</i>		<u>54,806</u>		<u>41,814</u>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>				
<i>Ekuiteti</i>				
Kapitali aksionar		16,000		15,000
Premia në aksione		3,365		2,496
Fitimet e mbajtura		15,629		6,465
		<u>34,994</u>		<u>23,961</u>
<i>Detyrimet afatgjata</i>				
9% nota kreditore		8,000		10,300
<i>Detyrimet afatshkurta</i>				
Mbitërheqja bankare	1,230		429	
Llogaritë e pagueshme	7,442		4,264	
Interesi i pagueshëm	120		100	
Tatimi i pagueshëm	<u>3,020</u>		<u>2,760</u>	
		11,812		7,553
<i>Totali i ekuitetit dhe detyrimeve</i>		<u>54,806</u>		<u>41,814</u>

Shënimet shtesë

- (a) Gjatë vitit dividendët e paguara ishin €1,486,000.
(b) Shënimet mbi lëvizjet në pasuritë e patundshme për vitin 2016 janë si në vijim.

	Kosto	Zhvlerësimi i akumuluar	Vlera neto në libra
	€'000	€'000	€'000
Saldo në fillim	33,218	6,644	26,574
Blerjet gjatë vitit	24,340		24,340
Shitjet	(2,964)	(990)	(1,974)
Zhvlerësimi vjetor		4,658	(4,658)
Saldo në fund	<u>54,594</u>	<u>10,312</u>	<u>44,282</u>

- (c) Gjithsej arkëtimet nga shitja e pasurive jo-qarkulluese ishin €2,694,000.

Kërkohet

Përgatitni Pasqyrën e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016, sipas kërkesave të SNK 7 me metoden indirekte.

Zgjidhja e problemit 1

EDRA

Pasqyra e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016

	€	€
<i>Paraja e gatshme nga aktivitetet operative</i>		
Fitimi para tatimit	15,000	
Zhvlerësimi	4,658	
Shpenzimet e interesit	730	
Fitimi në shitjen e pasurive jo qarkulluese (LL1)	<u>(720)</u>	
	19,668	
Rrënia në stoqe	6,075	
Rritja në të arkëtueshme	(1,863)	
Rritja në të pagueshme	<u>3,178</u>	
Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet	27,058	
Interesi i paguar (LL2)	(710)	
Tatimi i paguar (LL3)	<u>(4,090)</u>	
<i>Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet operative</i>		22,258
<i>Paraja e gatshme nga aktivitetet investuese</i>		
Blerjet e pasurive jo-qarkulluese	(24,340)	
Shitjet e pasurive jo-qarkulluese	<u>2,694</u>	
<i>Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet investuese</i>		(21,646)
<i>Paraja e gatshme nga aktivitetet financuese</i>		
Arkëtimet nga shitja e aksioneve	1,869	
Pagesa e kredisë	(2,300)	
Dividenda e paguar	<u>(1,486)</u>	
<i>Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet financuese</i>		<u>(1,917)</u>
<i>Rrjedha neto e parasë së gatshme gjatë vitit</i>		(1,305)
<i>Paraja e gatshme në fillim të periudhës</i>		634
<i>Paraja e gatshme në fund të periudhës</i>		<u>(671)</u>
<i>Llogaritjet</i>		
1 <i>Fitimi në shitjen e pasurive jo-qarkulluese</i>		€'000
Arkëtimet		2,694
VNL		<u>1,974</u>
Fitimi		<u>720</u>
2 <i>Interesi i paguar</i>	Interesi i pagueshëm	
	€'000	€'000
Interesi i paguar	710	Saldo në fillim
(shifër balancuese)		100
Saldo në fund	<u>120</u>	Shpenzimet
	<u>830</u>	<u>730</u>
		<u>830</u>
3 <i>Tatimi i paguar</i>	Tatimi i pagueshëm	
	€'000	€'000
Tatimi i paguar (shifër	4,090	Saldo në fillim
balancuese)		2,760
Saldo në fund	<u>3,020</u>	Shpenzimet
	<u>7,110</u>	<u>4,350</u>
		<u>7,110</u>

Problemi 2

Informatat e mëposhtme janë ekstraktuar nga librat e llogarive të Troja Sh.p.k. më 31 tetor 2016.

	Debi	Kredi
	€'000	€'000
Keshi	15	
Shpenzimet e sigurimit	75	
Stoqet më 01 nëntor 2015	350	
Shpenzimet e përgjithshme	60	
Shpenzimet e energjisë	66	
Shpenzimet e marketingut	50	
Rrogat dhe pagat	675	
Zbritjet e marra		50
Premia		200
Fitimet e mbajtura më 01 nëntor 2015		315
Lejimet më 01 nëntor 2015		40
Të hyrat		5,780
Shpenzimet e telefonit	80	
Shpenzimet e pronës	100	
Mbitërheqja bankare		94
Kthimet e shitjeve	95	
Llogaritë e pagueshme		290
Shpenzimet e interesit	33	
Llogaritë e arkëtueshme	900	
Blerjet	3,570	
Notat e pagueshme 7%		470
Borxhet e këqija (të shlyra)	150	
Aksionet e zakonshme 1€		1,800
Zhvlërësimi i akumuluar më 01 nëntor 2015		
Ndërtesat		360
Automjetet		80
Mobilje dhe pajisje		420
Toka me kosto	740	
Ndërtesat me kosto	1,500	
Automjetet me kosto	240	
Mobiljet dhe pajisjet me kosto	<u>1,200</u>	
	9,899	9,899

Juve ju janë dhënë gjithashtu informatat e mëposhtme:

- Stoqet më 31 tetor 2016 u vlerësuan 275,000€ në bazë të kostos së tyre historike. Megjithatë, stoqet me kosto prej 45,000€ kanë qenë në depo për dy vite me radhë dhe drejtorët janë dakorduar që t'i shesin në nëntor 2016 me një çmim prej 20,000€.
- Shpenzimet e marketingut përfshijnë një pagesë prej 5,000€ që lidhet me shpenzimet që do të realizohen në nëntor 2016.
- Lejimet për borxhet e dyshimta duhet të jenë 5% e llogarive të arkëtueshme.
- Janë 40,000€ detyrime për rrogat dhe pagat të paregjistruara për vitin që përfundon më 31 tetor 2016.
- Ndërtesat zhvlërësohen me 5% me metodën drejtvizore. Më 31 tetor 2016 ndërtesat u vlerësuan me vlerë prej 1,800,000€ dhe drejtorët dëshirojnë që ky vlerësim të inkorporohet në librat e llogarive.

- f) Zhvlerësimi duhet të ngarkohet si në vijim:
 - i. Automjetet me 20% me metodën e saldos zbritëse.
 - ii. Mobiljet dhe pajisjet me 20% me metodën drejtvizore.
- g) Nuk janë deklaruar apo paguar dividendë.
- h) Tatimi në korporata në vlerë prej 150,000€ duhet të regjistrohet.
- i) Gjatë tetorit 2016 është bërë një emetim bonus prej 1 aksioni për çdo 10 aksione për aksionarët e zakonshëm, duke përdorur llogarinë e premisë së aksioneve për këtë qëllim. Kjo nuk është regjistruar ende në librat e llogarive.

Kërkohet:

Përgatitni pasqyrat financiare të mëposhtme:

1. Pasqyrën e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 tetor 2016.
2. Pasqyrën e pozitës financiare më 31 tetor 2016.

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 2

Troja Sh.p.k.

Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 tetor 2016

		€ '000
Të hyrat nga shitja		5,780
Kthimet e shitjeve		<u>(95)</u>
Të hyrat nga shitja neto		5,685
Kosto e shitjes (L1.1)		<u>(3,670)</u>
Fitimi Bruto		2,015
Zbritjet e marra		<u>50</u>
		2,065
Shpenzimet:		
Sigurimi	75	
Të përgjithshme	60	
Energjisë	66	
Marketingut (50-5)	45	
Rrogat dhe Pagat (675+40)	715	
Telefonit	80	
Pronës	100	
Interesi	33	
Borxhet e këqija (L1.2)	155	
Zhvlerësimi (L1.3)	347	
		<u>(1,676)</u>
Fitimi para tatimit		389
Tatimi		<u>(150)</u>
Fitimi Neto		239

Troja Sh.p.k.
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 tetor 2016

	€ '000	€ '000	€ '000
	Kosto	Zh.Akumuluar	VNL
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Toka	740	-	740
Ndërtesat	1,800	-	1,800
Automjetet (Ll.3)	240	112	128
Mobiljet dhe pajisjet (Ll.3)	<u>1,200</u>	<u>660</u>	<u>540</u>
	3,980	772	3,208
 <i>Pasuritë qarkulluese</i>			
Stoqet (Ll.1)			250
Llogaritë e arkëtueshme	900		
Lejimet	<u>(45)</u>		
Llogaritë e arkëtueshme neto			855
Parapagimet (marketingu)			5
Keshi			<u>15</u>
			1,125
Total Pasuritë			4,333
 <i>Ekuiteti dhe Detyrimet</i>			
<i>Ekuiteti</i>			
Aksionet e zakonshme (Ll.4)			1,980
Premia (Ll.4)			20
Rezerva e Rivlerësimit (Ll.3)			735
Fitimet e mbajtura (315 + 239)			<u>554</u>
			3,289
<i>Detyrimet afatgjata</i>			
Notat e pagueshme 7%			<u>470</u>
			470
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>			
Llogaritë e pagueshme			290
Akrualet (Rrogat dhe Pagat)			40
Tatimi i pagueshëm			150
Overdrafti bankar			<u>94</u>
			574
Total Ekuiteti dhe Detyrimet			4,333

Llogaritjet

1. Kosto e shitjes

Stoqet në fillim	350
Blerjet	3,570
Stoqet në fund (275 - 45 + 20)	<u>(250)</u>
	3,670

2. Borxhet e këqija dhe të dyshimta

Llogaritë e arkëtueshme sipas Bilancit Vërtetues	900,000€
Lejimi i përgjithshëm: 900,000 x 5%	45,000€
Lejimi i përgjithshëm në fillim të vitit	<u>40,000€</u>
Rritja në lejime (shpenzime nga borxhet e dyshimta)	5,000€
Shpenzimet e borxheve të dyshimta	5,000€
Shpenzimet e borxheve të këqija sipas Bilancit Vërtetues	<u>150,000€</u>
	155,000€

3. Pasuritë jo-qarkulluese dhe zhvlerësimi

	Toka	Ndërtesat	Automjetet	Mobiljet dhe pajisjet
	€'000	€'000	€'000	€'000
Kosto	740	1,500	240	1,200
Zhvlerësimi i akumuluar në fillim	-	360	80	420
Shpenzimet e zhvlerësimit për vitin		1,500x5%=75	(240-80)x20%=32	1,200x20%=240
	-	(435)	(112)	(660)
VNL më 31.10.2016	740	1,065	128	540

Rivlerësimi i Ndërtesës:

Vlera Neto në Libra më 31.10.2016	1,065€
Vlerësimi	<u>1,800€</u>
Rezerva e Rivlerësimit	735€

4. Ekuiteti

Aksionet e zakonshme

Sipas Bilancit Vërtetues 1,800Aks x 1€	1,800€
Emetimi Bonus (1,800Aks / 10Aks x 1Aks) x 1€	<u>180€</u>
	1,980€

Premia e aksioneve

Sipas Bilancit Vërtetues	200€
Emetimi Bonus	<u>(180€)</u>
	20€

Problemi 3

Më poshtë janë pasqyrat financiare që lidhen me kompaninë me përgjegjësi të kufizuar Black dhe me kompaninë filiale të saj, Bury.

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Për vitin e përfunduar më 31 tetor 20X5

	<i>Black</i>	<i>Bury</i>
	€'000	€'000
Të hyrat nga shitja	245,000	95,000
Kosto e mallrave të shitur	<u>(140,000)</u>	<u>(52,000)</u>
Fitimi bruto	105,000	43,000
Shpenzimet e shpërndarjes	(12,000)	(10,000)
Shpenzimet administrative	(55,000)	(13,000)
Të ardhurat nga dividenda nga Bury	<u>7,000</u>	<u>-</u>
Fitimi para tatimit	45,000	20,000
Tatimi në fitim	<u>(13,250)</u>	<u>(5,000)</u>
Fitimi neto	<u><u>31,750</u></u>	<u><u>15,000</u></u>

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

më 31 tetor 20X5

	<i>Black</i>		<i>Bury</i>	
	€'000	€'000	€'000	€'000
<i>Pasuritë</i>				
Pasuri jo-qarkulluese				
Prona, impiantet dhe pajisjet		110,000		40,000
Investimet				
21,000,000 €1 aksionet e zakonshme në Bury		<u>21,000</u>		<u>-</u>
		131,000		40,000
Pasuri qarkulluese				
Stoqet	13,360		3,890	
Llogaritë e arkëtueshmet dhe dividenda e arkëtueshme	14,640		6,280	
Paraja në bankë	<u>3,500</u>		<u>2,570</u>	
<i>Gjithsej pasuritë</i>		<u><u>31,500</u></u>		<u><u>12,740</u></u>
		<u><u>162,500</u></u>		<u><u>52,740</u></u>
<i>DETYRIMET DHE EKUITETI</i>				
Ekuiteti				
€1 Aksionet e zakonshme		100,000		30,000
Fitimet e mbajtura		<u>33,500</u>		<u>10,280</u>
		133,500		40,280
Detyrimet afatshkurtëra				
Llogaritë e pagueshme tregtare	9,000		2,460	
Dividenda e pagueshme	<u>20,000</u>		<u>10,000</u>	
<i>Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti</i>		<u><u>29,000</u></u>		<u><u>12,460</u></u>
		<u><u>162,500</u></u>		<u><u>52,740</u></u>

Informacione shitesë

- (a) Black bleu aksione të zakonshme prej €1 në Bury më 1 nëntor 20X0. Në atë datë saldo e fitimeve të mbajtura të Bury ishte €2 milion. Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në datën e blerjes ishte €11,800,000. Emri i mirë në blerjen ishte €800,000.
- (b) Gjatë vitit që përfundoi më 31 tetor 20X5 Black i shiti mallra Bury-it që fillimisht kushtonin €12 milion. Black faturoi Bury-in me shtim mbi kosto prej 40%. Bury ende ka në stoqe 30% të këtyre mallrave të blera më 31 tetor 20X5.
- (c) Bury i ka borxh Black €1.5 milion më 31 October 20X5 për disa nga mallrat që Black e ka furnizuar gjatë vitit.

Kërkohet

- (a) Përgatitni pasqyrat financiare në vijim për Black.
 - (i) Pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave gjithëpërfshierse për vitin e përfunduar më 31 tetor 20X5. **(10 pikë)**
 - (ii) Pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 tetor 20X5. **(10 pikë)**

[Totali: 20 Pikë]

Zgjidhja(3)

(i) BLACK GRUP

PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIERSE
për vitin e përfunduar më 31 tetor 20X5

	€'000
Të hyrat (245 + 95 - 16.8 (LL2))	323,200
Kosto e mallrave dhe shërbimeve (140 + 52 - 16.8 +1.44)	<u>(176,640)</u>
Fitimi bruto	146,560
Shpenzimet e shpërndarjes (12 + 10)	(22,000)
Shpenzimet administrative (55 + 13)	<u>(68,000)</u>
Fitimi para tatimit	56,560
Tatimi në fitim (13.25 + 5)	<u>(18,250)</u>
Fitimi neto	<u><u>38,310</u></u>
U atribuohet	
Pronarët e kompanisë mëmë (shifer balancuese.)	33,810
Interesi jo-kontrollues (30% × 15)	<u>4,500</u>
	<u><u>38,310</u></u>


(ii) BLACK GRUP
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR
më 31 tetor 20X5

	€'000	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese		
Emri i mirë	800	
Prona, impiantet dhe pajisjet (110 + 40)	<u>150,000</u>	
		150,800
Pasuritë qarkulluese		
Stoqe (LL3)	15,810	
Llogaritë e arkëtueshme tregtare (LL4)	12,420	
Paraja në bankë (3.5 + 2.57)	<u>6,070</u>	
		<u>34,300</u>
<i>Gjithsej pasuritë</i>		<u><u>185,100</u></u>
 <i>Detyrimet dhe Ekuiteti</i>		
Ekuiteti që i atribuohet pronarëve të kompanisë mëmë		
Kapitali Aksionar	100,000	
Fitimet e mbajtura (LL6)	<u>37,856</u>	
		137,856
Interesi jo-kontrollues (LL7)	-	14,284
 Detyrimet afatshkurtëra		
Llogaritë e pagueshme tregtare (LL5)	9,960	
Obligimet ndaj aksionarëve për dividenda (20+ (10× 30%))	<u>23,000</u>	
		<u>32,960</u>
<i>Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti</i>		<u><u>185,100</u></u>

Llogaritjet

(a) Llogaritja e emrit të mirë	€'000	€'000
Vlera e drejtë e konsiderates së transferuar	21,000	
Plus vlera e drejtë e interesit jo-kontrolluese në blerje	<u>11,800</u>	
		32,800
Minus vlera e drejtë e blerjes neto e pasurive të identifikueshme dhe detyrimeve të marra:		
Kapitali aksionar	30,000	
Fitimet e mbajtura në blerje	<u>2,000</u>	
	-	<u>(32,000)</u>
Emri i mirë		<u>800</u>

1 Struktura e grupit



2 Shitjet brenda grupit

Çmimi i shitjes për t'u eliminuar nga të ardhurat e konsoliduar:

	€'000
Kosto për Black	12,000
40% shtim mbi kosto	<u>4,800</u>
Kosto për Bury	<u>16,800</u>

Fitimi i porealizuar në stoqe: €4,800,000 × 30% = €1,440,000

3 Stoqet	€'000
Black	13,360
Bury	3,890
Minus fitimi i porealizuar (LL2)	<u>(1,440)</u>
	<u>15,810</u>

4	<i>Llogaritë e arkëtueshme</i>	€'000	€'000
	Black	14,640	
	Minus dividenta e arkëtueshme	<u>(7,000)</u>	
			7,640
	Bury		6,280
	Minus të arkëtueshmet nga tregtia ndergrupore		<u>(1,500)</u>
			<u>12,420</u>
5	<i>Llogaritë e pagueshme</i>		€'000
	Black		9,000
	Bury		2,460
	Minus të pagueshmet nga tregtia ndergrupore		<u>(1,500)</u>
			<u>9,960</u>
6	<i>Fitimet e mbajtura</i>	<i>Black</i>	<i>Bury</i>
		€'000	€'000
	Sipas pyetjes	33,500	10,280
	fitimi i perealizuar (LL2)	(1,440)	-
	Fitimet e mbajtura ne blerje		<u>(2,000)</u>
			<u>8,280</u>
	Pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura:		
	Bury (70% × 8,280)	<u>5,796</u>	
	Fitimet e mbajtura të grupit	<u>37,856</u>	
7	<i>Interesi jo-kontrollues</i>		€'000
	Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në blerje		11,800
	Plus pjesa e interesit jo-kontrollues nga fitimet e mbajtura pas blerjes		<u>2,484</u>
	(30% × 8,280)		
	Interesi jo-kontrollues në datën e raportimit		<u>14,284</u>

Problemi 4

(i) Përshkruani qëllimin e Pasqyrës së Ndryshimeve në Ekuitet.

(2 pikë)

(ii) Duke përdorur informatat e përshtatshme nga lista e mëposhtme përgatiteni një Pasqyrë të Ndryshimeve në Ekuitet më 31 Dhjetor 2017.

Informatat që lidhen me vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016

	000 Eur
Ndryshimi në politikën e kontabilitetit	800 në Kredi
Bilancet(saldot) më 1 janar 2016	
Kapitali aksionar	500,000
Fitimet e mbajtura	235,780 Kredi
Dividenda e paguar gjatë vitit	20,000
Fitimi neto gjatë vitit	45,000

Informatat për vitin që mbaron më 31 Dhjetor 2017

	000 Eur
100,000 aksione me vlerë nominale 1Eur të shitura për 1.5 Eur	150,000
Dividenda e paguar gjatë vitit	35,000
Fitimi neto gjatë vitit	50,000

(10 pikë)

(c) Kompanitë në ditët e sotme për ta rritur edhe më tutje aktivitetin e tyre preferojnë rritjen e kapitalit edhe duke emetuar aksione. Përveç të tjerave janë të mundshme edhe dy mënyra të emetimeve : Emetimi bonus dhe emetimi i të drejtave.

Kërkohet:

a) Diskutoni përparësitë dhe mangësitë e emetimit bonus .

b) Diskutoni përparësitë dhe mangësitë e emetimit të drejtave.

(8 pikë)

(Totali 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

a)

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet-është në kuadrin e pasqyrave të publikuara financiare. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet ka për qëllim të paraqet detajet e ndryshimeve në kapitalin ,fitimet e mbajtura dhe rezervat e tjera.

b)

	Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet		
	Kapitali aksionar	Fitimi i mbajtur	Premia
Saldo ne fillim 2016	500,000	235780	
Dividenda		(20,000)	
Ndryshimi ne politike		800	
Fitimi i vitit		45,000	
Saldo me 1 Janar 2017	500,000	261,580	
Emetim i aksioneve	100,000		50,000
Dividenda		(35000)	
Fitimi i vitit		50,000	
Saldo ne fund 2017	600,000	276,580	50,000

c)

Emetimi bonus -i aksioneve paraqet emetimin që e bënë një kompani për aksionarët e vet duke iu japë aksione bonus në proporcion me aksionet që i kanë në pronësi.

Kjo bëhet duke i ri-klasifikuar rezervat sic janë: premia dhe fitimet e mbajtura.

Përparësitë janë se :

-Rrite kapitalin pa i ulur vlerën e asaj që kanë në dorë aksionarët aktualë.

-Kapitalizon rezervat, në këtë mënyrë ato nuk mund të iu paguhen aksionarëve.

Mangësitë janë :

Nuk sjell para të gatshme në kompani.

Mund të vërë në rrezik pagesat e dividendëve të ardhshëm nëse bien fitimet e kompanisë.

Emetimi t ë drejtave -paraqet emetim të aksioneve duke iu japur së pari aksionarëve mundësinë që ti blejnë ato aksione, zakonisht më çmim më të ulët se në treg.

Përparësitë janë :

Sjell para të gatshme në kompani.

I ruan rezervat për dividend në të ardhmen.

Mangësitë janë :

Zvogëlohet ajo që kanë në dorë aksionarët në rast se ata nuk i shfrytëzojnë këto të drejta.

Problemi 5

Majk Sh.p.k., një klient që posedon dyqane për shitjen e harduerëve, ka kërkuar nga ju për të e këshilluar në lidhje me SNK 37, *Provizionet: Pasuritë dhe Detyrimet Kontingjente*.

Kërkohet:

- a) Shpjegoni kriteret e njohjes së Provizionit në përputhje me SNK 37, *Provizionet: Pasuritë dhe Detyrimet Kontingjente*. **(5 pikë)**
- b) Shpjegoni se si matet Provizionit. **(5 pikë)**
- c) Majk Sh.p.k. shet makina larëse nën një garancion me të cilin mbulohen shpenzimet e riparimeve për çdo defekt prodhimi të zbuluar brenda gjashtë muajve nga realizimi i shitjes. Nëse zbulohen defekte të vogla të gjitha makinat larëse të shitura, atëherë duhet të njihen shpenzimet e riparimit në vlerë prej 200,000€. Nëse zbulohen defekte të mëdha në të gjitha makinat larëse të shitura, atëherë duhet të njihen shpenzimet e riparimit në vlerë prej 500,000€. Nga përvoja e tij si dhe parashikimet e bëra tregojnë se në gjashtë muajt e ardhshëm, 85% e makinave larëse nuk do të kenë defekte, 10% do të kenë defekte të vogla dhe 5% do të kenë defekte të mëdha.

Kërkohet: Diskutoni nëse duhet të njihet ndonjë provizion në lidhje me makinat larëse dhe nëse po, kalkuloni shumën e provizionit që duhet të njihet. **(10 pikë)**

Totali 20 pikë

Zgjidhja e problemit 5

Raport

Për: Majk Sh.p.k.

Nga: Kontabilisti Financiar

Re: SNK 37 – Provizionet: Detyrimet dhe Pasuritë Kontingjente

Data: Janar 2017

- a) Sipas paragrafit 14 të SNK 37, provizioni duhet të njihet kur:
- Entiteti ka një obligim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën;
 - Ka shumë mundësi (gjasa) që të nevojitet një transfer i përfitimeve ekonomike për të shlyer obligimin në fjalë
 - Vlera monetare e obligimit mund të vlerësohet me besueshmëri

Nëse këto kushte nuk arrihen, nuk duhet të njihet provizioni.

- b) Sipas paragrafëve 36 dhe 37 të SNK 37, shuma e njohur si provizion është vlerësimi më i mirë i shpenzimeve të kërkuara për të shlyer obligimin aktual në fund të periudhës raportuese. Vlerësimi më i mirë është shuma që njësitë ekonomike do të e paguante në mënyrë të arsyeshme për të shlyer obligimin në fund të periudhës raportuese ose të transferojë atë tek një palë e tretë në atë kohë.
- c) Në fund të periudhës raportuese ekziston një obligim aktual bazuar në evidencën historike të këtyre artikujve të cilët riparohen sipas marrëveshjes së garancionit. Një numër i madh i artikujve është përfshirë dhe për këtë arsye është bërë një provizion për vlerën e pritshme të daljes së përfitimeve ekonomike, si në vijim:

$$\begin{aligned} \text{Shuma e provizionit: } & 85\% \times \text{pa defekte} + 10\% \times 200,000\text{€} + 5\% \times 500,000\text{€} \\ & = 0\text{€} + 20,000\text{€} + 25,000\text{€} = 45,000\text{€} \end{aligned}$$

Shpresoj se informatat e dhëna më sipër ju japin sqarime të mjaftueshme dhe i përgjigjen pyetjeve tuaja. Për më shumë informata, ju lutem mos hezitoni të më kontaktoni!

Me respekt,

Kontabilisti Financiar